



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E VËZHguesve AFATGJATË TË PANELIT ZGJEDHOR PËR
ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS
30 QERSHOR, 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 06.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

OBJEKT: Miratimi i vëzhguesve afatgjatë të paraqitur nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) të Republikës së Kosovës, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"

V Ë R E N

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa është organ i përhershëm, i pavarur, kompetent i cili vendos në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me



Nr.798 i Vendimit

Data 06.06.2019 Ora 18 .⁰⁰ e Vendimit

Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor, 2019

procesin zgjedhor në Republikën e Kosovës. Ky Panel Zgjedhor ka marrë pjesë në vëzhgimin e disa proceseve zgjedhore në Shqipëri ku janë njohur nga afër dhe kanë kuptuar procesin zgjedhor duke përfshirë dhe zgjidhjen e ankimeve zgjedhore nga ana e Kolegjit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

PZAP-i ka paraqitur kërkesën e saj bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ-së për akreditimin e 9 (nëntë) vëzhguesve afatgjatë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se ai është brenda kushteve dhe kërkesave të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4,5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) për akreditimin e 9 (nëntë) vëzhguesve afatgjatë për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019, sipas listës të përcaktuar në lidhjen Nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr.798 i Vendimit

Data 06.06.2019 Ora 18 .⁰⁰ e Vendimit

Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor, 2019